



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

**NJOFTIM**

**PËR VEND VAKANT**

**ARKIVIST/E**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kërkon të punësojë në pozicionin **1 (një) punonjës në administratë me detyrë "Arkivist/e"**.

Bazuar në nr. 97/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë",

**NJOFTON:**

Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin **1 (një) vend "Arkivist/e"** në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Kandidatët e interesuar për konkurim duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

**1. Kushtet e përgjithshme:**

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë apo mos të ketë qënë nën hetim;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore në marrëdhënie punë dhe/ose shërbim civil, që nuk është shuar sipas ligjit;

- e) të ketë përfunduar ciklin e parë të studimit Bachelor dhe ciklin e dytë të studimeve universitare. Preferohen studimet në drejtimin drejtësi, histori, si dhe fusha të tjera që kanë të bëjnë me arkivat, statistikën etj.

## **2. Kushtet e posaçme:**

- a) Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
- b) Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.
- c) Të ruajë sekretin hetimor.
- d) Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale si dhe sjellje etike.
- e) Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si Microsoft: word, excel, power point, etj.
- f) Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja.
- g) Të ketë njohuri dhe ekspertizë në fushën e arkivave, administrimit të dokumentacionit, ruajtjes, klasifikimit dhe përpunimit të dokumentacionit si dhe në fushën e përpunimit të dokumentacionit procedural dhe atij administrative sipas rregullave tekniko-shkencore.

## **3. Kritere të preferuara :**

- a) Të ketë njohje të sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.
- b) Të ketë kualifikime, njohje ose eksperiencë në fushën e zbatimit dhe/ose praktikimit të legjislacionit përkatës në fushën e të drejtës administrative, të ligjeve organike të drejtësisë si dhe në fushën e arkivave (eksperienca si rregull mbi 1 vit).
- c) Të jetë i/e pajisur me çertifikatë të sigurisë së personelit nga DSIK, e cila të jetë brenda afatit të vlefshmërisë ose të jetë i/e gatshëm për t'iu nënshtruar procedurave të pajisjes me CSP.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, deri në datën **22.11.2022 ora 16.00, këto dokumenta:**

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së lartë, master, çertifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.
- g) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- h) Vërtetim mbi masat disiplinore në fuqi.
- i) Vërtetim vendbanimi.
- j) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.
- k) Referenca të mundshme nga punëdhënësi të mëparshëm.

- l) Formular vetdeklarimi për gjendjen gjyqësore penale si dhe për kontakte me persona të dënuar/proceduar penalisht (formularët mund të tërhiqen në sekretarinë e prokurorisë).

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, **deri në datën 22.11.2022 ora 16.00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.**

Konkurimi zhvillohet në dy faza :

Verifikimi paraprak : vlerësimi i dokumentacionit dhe intervista.

Vlerësimi : testimi me shkrim.

Verifikimi paraprak i kandidatëve do të bëhet nga Kancelarja e kësaj Prokurorie, e cila pasi të marrë praktikat dokumentare për secilin kandidat duhet të verifikojë nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe veçanta.

Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Pranimi do të bëhet bazuar në dokumentacionin e secilit kandidat, rezultatit të intervistës me secilin prej tyre si dhe testimin me shkrim.

Drejtuesi i Prokurorisë është organi në të cilin aplikuesit mund të paraqesin ankimmimet/kundërshtimet e mundshme mbi cdo vendim të marrë në cdo fazë të konkurimit. Afati i ankimit është 5 ditë nga e nesërmja e njoftimit.

Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, **në datë 23.11.2022, nga ora 11.00 e në vijim.**

Testimit me shkrim me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, **në datë 24.11.2022, ora 10.00.**

Ky testim do të përmbajë pyetje nga:

- Kodi Penal RSH.
- Kodi Procedurës Penale RSH.
- Kodi Procedurave Administrative RSH.
- Ligji nr.97/2016.
- Rregullore e brendshme e Prokurorisë Elbasan.
- Ligji për arkivat.
- Rregullat e përpunimit tekniko-shkencor të dokumentacionit.
- Rregullat mbi metodikën dhe tipologjinë e menaxhimit të arkivës gjyqësore.

Pikëzimi i renditjes së aplikantëve është si vijon :

- Dokumentacioni 20 pikë.
- Intervista 40 pikë.
- Testimi 40 pikë.

Konsiderohen të kualifikuar kandidatët që në përfundim të procesit kanë marrë më shumë se 70 pikë.

Njoftimi i datës së intervistimit dhe testimit me shkrim konsiderohen të realizuara me anë të këtij njoftimi. Procedura e konkurimit bazohet në rregullat e vendosura në urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë. Kandidatët e interesuar mund të tërheqin një kopje të këtij urdhëri pranë Kryesekretarisë së Prokurorisë.

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin 054242674, ose vizitoni faqen e internetit [www.pp.gov.al](http://www.pp.gov.al).

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN**